

VENDIM
Nr. 653, datë 25.9.2019

PËR CAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, SI PËRFAQËSUES I PËRFITUESIT PËR OBJEKTIVIN 2, “MBËSHTETJA PËR TURIZMIN SI NJË MODEL PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK LOKAL”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, pikat 2, shkronja “b”, e 4, të marrëveshjes kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), ratifikuar me ligjin nr. 37/2015, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi Shqiptar i Zhvillimit caktohet si përfaqësues i përfituesit të IPA II, për sa i përket objektivit 2, “Mbështetja për turizmin si një model për zhvillimin ekonomik lokal”, në kuadër të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian për programin e veprimt IPA, për vitin 2017, për Shqipërinë.

2. Fondi Shqiptar i Zhvillimit caktohet si agjenci zbatuese për ato kategori ndërhyrjesh që përfshihen në këtë objektiv, në përputhje me parashikimet e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian dhe marrëveshjes së delegimit, ndërmjet Komisionit të Bashkimit Evropian dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

3. Fondi Shqiptar i Zhvillimit të bashkëpunojë me Delegacionin Evropian në Tiranë, BERZH, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Kulturës dhe bashkitë, për programimin dhe integrimin e ndërhyrjeve brenda këtij programi, si dhe bashkërendimin e tyre me ndërhyrjet e parashikuara në programe të tjera, në proces planifikimi dhe zbatimi nga FSHZH-ja.

4. Ngarkohen Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe